



# REKOMANDIM ME ARDHMËRI?

Koment me rastin e Raportit të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë nga data 17 prill 2018

18 prill 2018



Instituti  
për  
politikë  
evropiane.  
Shkup



# REKOMANDIM ME ARDHMËRI?

Koment me rastin e Raportit të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë nga data 17 prill 2018



Botues:

Instituti për Politikë Evropiane - Shkup

Autorë:

Dr. Malinka Ristevska Jordanova

Dr. Simonida Kacarska

Dr. Ardita Abazi Imeri

Mr. Aleksandar Jovanovski

Mr. Aleksandra Ivanovska

Mr. Iva Conevska

Mr. Ismail Kamberi

Disenji grafik:

Relativ

# REKOMANDIMI ME ARDHMËRI?

Rekomandimi përsëritet. Ndryshe nga rekomandimi i fundit i vitit 2014, i cili ishte më ngushëllues, ky rekomandim është me perspektivë.

Raporti i mundeson erë velave të anijes së Qeverisë për:

1. Reformat
2. Zgjedhjen e kontestit për emrin.

Rekomandimi është përfocuar edhe me kapitullin e ri në hyrje, i dedikuar për progresin drejt plotësimit të kushteve për fillimin e negociatave, në të cilën Komisioni jep arsyet për rekomandimin - një vlerësim pozitiv të zbatimit të Marrëveshjes së Przhinos dhe Prioriteteve të Reformave Urgjente. Çështja e emrit nuk është përmendur në këtë seksion, as në konkluzionet e Strategjisë, si pjesë që kanë ndikim më të madh politik. Komisioni mbetet në një nga formulimet e mëhershme edhe atë në pjesën e bashkëpunimit rajonal - kontesti duhet të adresohen urgjentisht.

Komisioni paralajmëron aplikimin e një «qasjeje të përforcuar të kapitujve mbi gjyqësorin dhe të drejtave themelore dhe drejtësa, liria dhe siguria.» Kjo duhet të nënkuptojë fillimin e shqyrtimit analitik (skrining), që është, faza e parë e negociatave.

Me këtë qasje - qasje nxitëse, Komisioni i lë më shumë hapësirë në bisedimet për emrin Republikës së Maqedonisë.

Perspektiva e vetme për këtë rekomandim është që të jetë e fundit. Ajo ende do të varet nga zgjidhja e kontestit për emrin – pa marrë parasysh nëse ajo do të lidhet përsëri me fillimin e negociatave, që është më kyçe ose do të kërkohen modalitete të tjera.

Mosrealizimi eventual i këtij rekomandimi «të pastër» është një rrezik i madh për Republikën e Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian - për stabilitetin e brendshëm dhe rajonal si dhe besueshmërinë e procesit të zgjerimit e cila është në qendër të strategjisë për zgjerimin e BE-së në vitin 2018. Ndërgjegjësimi për këtë rrezik është prezent në këtë Raport.

Para Qeverisë mbetet sfida më e madhe për të vazhduar zgjidhjen e kontestit për emrin, në drejtim të një zgjidhjeje që është e pranueshme për qytetarët e Maqedonisë.



**Kriteret politike:  
një kthim vendimtar drejt  
vlerave demokratike**

Vlerësime jashtëzakonisht të favorshme hasen sa i përket qëndrimit të Qeverisë ndaj parimeve themelore të sundimit të ligjit, dialogut me shoqërinë dhe opozitën, si dhe hapat e ndërmarrë për ndarjen e shtetit dhe partisë. Sado që të jemi kritik për punën e kësaj qeverie, dhe për të gjitha kompromiset e brendshme politike që kishte për ti bërë, duhet të pranohet se në parimet themelore demokratike në politikën ndërkombëtare, ajo bëri një përparim të shquar për një vit. Shume kohë nuk kemi parë një formulim të «përparimit të mirë» për fushat kryesore në kriteret politike - gjyqësori, administrata publike, liria e shprehjes, marrëdhëniet me organizatat e shoqërisë civile.

Kriteret politike janë ende modeste në vlerësimin e tyre për progresin dhe statusin në perpjekjet për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Priten gjykime për subjekte të profilit të lartë.

Komisioni i vlerëson pozitivisht udhëzimet strategjike për administratën publike, por tashmë vë në dukje nevojën për vullnet të fortë politik për emërimet profesionale të nivelit të lartë.

Struktura e Raportit ka ndryshuar - Kapitujt 23 dhe 24 vijnë menjëherë pas kriterëve politike, jo në seksionin «obligimet nga anëtarësimi», në mënyrë që të theksohet rëndësia e tyre, që ishte qëllimi i Strategjisë së Shkurtit 2018.

Do të jetë vendimtare pas këtij viti të sigurohet qëndrueshmëri në zbatim, e cila është një nga detyrat më të vështira të anëtarësimit.



## Kriteret ekonomike: ritja e transparencës


Sa i përket kriterëve ekonomike, KE njih progresin dhe përmirësimet e rëndësishme në menaxhimin e financave publike dhe transparencës, ndër të tjera përmes shpalljes së buxheteve qytetare për vitet 2017 dhe 2018. Miratimi i Programit të Menaxhimit të Financave Publike është i mirëpritur. Dobësitë kryesore të theksuara nga Raporti kanë të bëjnë me mjedisin e biznesit si dhe me problemet strukturore të tregut të punës, të reflektuara në shkallën e lartë të papunësisë. Në përgjithësi, KE vlerëson se vendi ka bërë njëfarë progresi dhe është në një nivel të mirë të përgatitjes për të zhvilluar një ekonomi tregu funksionale, e cila në realitet paraqet një stagnim krahasuar me vitin 2006. Rekomandohet që vendi të zhvillojë masa të qëndrueshme të konsolidimit. Ngjashëm me pjesën më sipër, KE gjen se ekonomia ka bërë njëfarë progresi dhe është pothuajse e gatshme për t'u përballur me konkurrencën dhe forcat e tregut në BE. KE sheh mangësi në programet arsimore që nuk përputhen me kërkesat e tregut.





## Bashkëpunimi rajonal: një hap i fortë përpara

Formulimi se kontesti rreth emrit me Greqinë duhet të zgjidhet urgjentisht paraqitet që në raportin e vitit 2014. Ky raport përsërit se vendi ka vazhduar të mbajë marrëdhënie të mira me vendet e tjera në procesin e zgjerimit përmes pjesëmarrjes aktive në iniciativat rajonale. Janë marrë vendime vendimtare për të nxitur marrëdhëniet e mira fqinjësore, në veçanti hyrjen në fuqi të marrëveshjes bilaterale për miqësinë me Bullgarinë. Negociatat intensive midis Maqedonisë dhe Greqisë janë pershendetur si dhe deklarata e përbashkët midis dy kryeministrave të dy vendeve.




## Harmonizimi me acquis i neglizhuar, koordinimi i dobët

Rezultatet nga pothuaj një vit e gjysmë, dhe rrjedhimisht, vlerësimet në Raport për kapitujt e acquis janë të këqija. Në raportin e këtij viti vlerësimi «progres i mirë» haset vetëm në kapitujt që lidhen me kriteret politike - 23 dhe 24. «progress i caktuar» mund të haset në 23 kapituj, dhe progresi është i barabartë me 0 ndërsa rekomandimet nuk janë zbatuar në 8 kapituj. Vlerësime të tilla të BE-së janë shqetësuese, veçanërisht duke pasur parasysh se vetëm 3-4 vite më parë Maqedonia paraprinte në rajon sa i përket nivelit të pajtueshmërisë me acquis. Për shembull, niveli i pajtueshmërisë në kapitullin më të vështirë për mjedisin ka rënë. Nga ana tjetër, niveli i pajtueshmërisë për kapitullin shumë të vështirë për sigurinë e ushqimit është ngritur në mënyrë të konsiderueshme - e cila është e vetmja pikë e ndritshme sa i përket kapitujve (në qoftë se i përjashtojmë dy kapitujt e qasjes «bazat në fillim»).

Kjo ngecje mund të shpjegohet pjesërisht duke patur parasysh kapacitetin e reduktuar të administratës shumë të partizuar gjatë periudhës së kaluar, por kjo nuk është shpjegim i mjaftueshëm. Është e qartë se qeveria duke i dhënë prioritet kriterëve politike dhe bashkëpunimit rajonal e ka lënë pas dore punën e kapitujve - harmonizimin e politikave dhe legjislacionit, implementimin dhe zbatimin e tyre. Përveç kësaj, KE konstaton edhe një nivel të ulët të cilësisë së sistemit të koordinimit të integritimit evropian, si për masat e politikave ashtu dhe për zbatimin e ndihmës. Qeveria duhet ta ndërpres këtë tendencë negative dhe të marrë masa urgjente për të forcuar kapacitetin e saj të pajtueshmërisë me acquis dhe koordinimin e integritimit evropian - si administrativ ashtu edhe politik. Ky është prioriteti i ardhshëm kyç nëse Maqedonia ka tendenca serioze për hapjen e negociatave me BE.

Nga ana tjetër, këto rezultate mund të interpretohen si një nën-produkt i strategjisë së ndryshuar të BE, e cila fuqimisht prioritzonte parimin «bazat në fillim» dhe agjendën e zhvillimit, në krahasim me harmonizimin me acquis.





## PERSPEKTIVA

Fakti që çështja e emrit nuk është e potencuar, nuk e zvogëlon rëndësinë e rezultatit të negociatave për emrin e fatit të rekomandimit.

## KONKLUZIONET PËRFUNDIMTARE DHE REKOMANDIMET

1. Raporti ofron nxitje për reformat e Republikës së Maqedonisë dhe njeh qartë vullnetin dhe angazhimin e Qeverisë.
2. Vlerësimet e kritereve politike, në veçanti gjyqësori dhe administrata publike, janë jashtëzakonisht pozitive.
3. Arritja kryesore në kriteret ekonomike është rritja e transparencës dhe llogaridhënies ndaj financave publike.
4. Është shqetësuese vonesa e rëndësishme në harmonizimin me politikat dhe legjislacionin e BE-së, si dhe cilësina e dobët e koordinimit të politikës evropiane.
5. Është e nevojshme, përveç ruajtjes së drejtimit të mirë në reformat demokratike dhe bashkëpunimin rajonal, Qeveria të vendosë si prioritet dhe harmonizim me politikat dhe legjislacionin e BE-së, si dhe reformat strukturore ekonomike.
6. Gatishmëria për negociata gjithashtu duhet të demonstrohet nga Qeveria përmes ndërtimit të kapaciteteve reale - politike dhe administrative - për koordinimin e politikës evropiane.
7. KE, krahas prioritetit të parimit të «bazat në fillim», duhet të nxisë sa më tepër harmonizimin me politikat dhe legjislacionin e BE-së. Në të njëjtën kohë, BE duhet të forcojë ndjeshëm mbështetjen për reformat e nevojshme në këtë drejtim, duke i trajtuar ato nga këndvështrimi më i gjerë ekonomik dhe social.



## Shtojca :

Pasqyra e konkluzioneve dhe vlerësimeve lidhur me përmbushjen e detyrimeve nga anëtarësimi

Kapitulli	Progresi							Niveli I harmonizimit	
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2018	2016	2018
1. Qarkullimi i Lirë i Mallrave	1	2	1	1	1	1	0	3	3
2. Lëvizja e Lirë e Punëtorëve	1	1	1	1	1	1	0	1	1
3. E Drejta e Themelimit dhe Liria e Sigurimit të Shërbimeve	1	1	1	1	1	1	0	3	3
4. Qarkullimi i Lirë i Kapitalit	1	1	1	1	1	1	1	3	3
5. Prokurime Publike	1	1	2	1	1	0	1	3	3
6. E drejta e Shoqërive Tregtare	2	2	2	2	1	1	1	4	4
7. E drejta e Pronës Intelektuale	1	1	1	1	1	1	1	3	3
8. Politika e Konkurrencës	1	2	2	2	1	0	0	3	3
9. Shërbimet financiare	2	1	1	1	1	1	1	3	3
10. Shoqëria Informatike dhe Mediat	1	1	1	2	1	0	0	4	3
11. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	1	1	1	1	1	1	1	3	3
12. Siguria e Ushqimit, Politika Veterinare dhe Fitosanitare	2	2	2	1	1	1	1	2	4
13. Peshkimi	1	1	1	1	1	2	0	3	3
14. Politika e Komunikacionit	1	1	1	1	1	1	1	3	3
15. Energjia	2	1	1	1	1	1	1	3	3
16. Tatimimi	1	1	1	1	1	1	1	3	3
17. Politika ekonomike dhe monetare	3	1	1	1	1	1	1	3	3
18. Statistika	2	1	2	2	1	1	1	3	3
19. Politikat Sociale dhe Punësimi	1	1	1	1	1	1	1	3	3
20. Ndërmarrjet dhe politika industriale	1	1	1	1	1	1	0	3	3
21. Rrjete trans-europiane	1	1	1	1	2	2	1	4	4
22. Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore	1	1	1	1	0	1	1	3	3
23. Gjyqësori dhe të drejtat themelore	1	1	1	1	0	0	2	2	2
24. Drejtësia, Liria dhe Siguria	1	1	1	1	1	1	2	3	3
25. Shkenca dhe Hulumtimi	1	1	2	2	2	1	1	4	4
26. Arsimi dhe kultura	1	1	1	1	1	1	1	3	3
27. Mjedis jetësor	1	1	1	1	1	1	1	2	2
28. Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbrojtje shëndetësore	1	1	1	1	1	0	0	3	3
29. Unioni Doganor	2	1	1	1	2	1	1	4	4
30. Marrëdhëniet me Jashtë	1	1	1	1	1	1	1	3	3
31. Politika e jashtme, e Sigurisë dhe Mbrojtjes	2	2	3	1	1	1	1	3	3
32. Kontrolli financiar	1	1	1	1	1	0	1	3	3
33. Dispozitat financiare dhe buxhetore	1	1	0	1	1	1	1	1	1

**Shënim: Instituti përdor metodologjinë e vet, me ç'rast në pasqyrimin e vlerësimit të përgjithshëm, vlera e kapitujve të veçantë është ponderuar duke e pasur parasysh vëllimin dhe rëndësinë e tyre**

*Shpjegime për kuantifikimin e vlerësimeve sa i përket progresit dhe përputhshmërisë*

*Vlerësimet e përdorura për raportet gjer në vitin 2014:*

## **Progresi**

Vlerësimi	Vlera numerike
	(-5)-(-1)
Regres	0
Nuk ka progres; nuk ka progres të mëtutjeshëm	1
Nuk ka progres thelbësor; nuk ka progres të veçantë; progres i pakënaqshëm; progres i ngadaltë; progres fillestar, progres i kufizuar	2
Progres i vogël; progres modest, progres i caktuar	3
Progres; progres i mëtutjeshëm	4
Progres i mirë; progres evident; progres i qëndrueshëm; progres i kënaqshëm	5

## **Përputhshmëria**

Vlerësimi	Vlera numerike
Nuk ka filluar	0
Faza e hershme; faza shumë e hershme; faza fillestare	1
Nuk ka shënuar progres të madh; shënon progres; progres i ngadalshëm	2
Progres mesatar	3
Progres i avancuar, në fazë të avancuar	4
Progres i mirë	5



## Vlerësimet për vitin 2015, 2016 dhe 2018, në përputhje me metodologjinë e Komisionit Europian

Vlerësimi i progresit	Vlera numerike
Regres	(-5)-(-1)
Nuk ka progres	0
Progres i caktuar	1
Progres i mirë	2
Progres domethënës	3

Vlerësimi i përputhshmërisë	Vlera numerike
Nuk ka filluar	0
Fazë e hershme e gatishmërisë	1
Niveli i caktuar i gatishmërisë	2
Niveli i moderuar i gatishmërisë	3
Niveli i mirë i gatishmërisë	4
Niveli i lartë i gatishmërisë	5

*Për të siguruar krahasueshmëri sipas metodologjisë së re të Komisionit europian me vlerësime më parë të dhëna, është bërë rivalorizim i vlerave për vitin 2013.*

*Analizat e Institutit për politikë europiane për raportet e mëparshëm të KE i gjeni në:*

- 2016: <https://goo.gl/RZFVU9> (MKD); <https://goo.gl/h13TQK> (ALB); <https://goo.gl/shdpvs> (ENG)
- 2015: <https://goo.gl/QB99q> (MKD); <https://goo.gl/9r7ZTs> (ALB); <https://goo.gl/OF6L7Y> (ENG)
- 2014: <https://goo.gl/pOJiOJ> (MKD); <https://goo.gl/eBjt4v> (ALB); <https://goo.gl/2RkFnU> (ENG)
- 2013: <https://goo.gl/sBwze9> (MKD); <https://goo.gl/sBwze9> (ALB); <https://goo.gl/sBwze9> (ENG)
- 2012: <https://goo.gl/5LkbqQ> (MKD); <https://goo.gl/5LkbqQ> (ALB); <https://goo.gl/ROcPl3> (ENG)
- 2011: <https://goo.gl/6uWzI6> (MKD); <https://goo.gl/ikAhRx> (ALB); <https://goo.gl/f47DTe> (ENG)